



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

SHPLLJE PËR VENDE TË LIRA PUNE

në kuadër të implementimit të projektit “AR.C.H.ETHICS, “të programit URBACT IV

Në mbështetje dhe në zbatim të Nenit 64/a e vijues, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, si dhe Kontratës për projektin “AR.C.H.ETHICS” lidhur më 01.08.2023 midis Agjensisë Kombëtare të Kohezionit Territorial dhe partnerit Kryesor të projektit Qyteti i Cesenës, Itali dhe Marrëveshja e bashkëpunimit midis partnerëve të projektit, firmosur më datë 18.08.2023 nga Bashkia Përmet, shpallet procedurat e konkurimit për vendin e lirë:

Koordinator i grupit lokal të veprimit (koordinatori ULG) për projektin “AR.C.H.ETHICS” I-Pozicioni koordinator i grupit lokal të veprimit (koordinatori ULG)

a-Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore

- Koordinator i Grupit Lokal të Veprimit është pika e referencës të cilit i referohet Partneri Kryesor dhe Eksperti Drejtues për të gjitha çështjet e Grupit Lokal të Veprimit.
- Është përgjegjës për të krijuar, drejtuar dhe menaxhuar Grupin Lokal të Veprimit, me objektiva të qarta dhe krijimin e një mjedisi mikpritës për të gjithë anëtarët e grupit.
- Organizojë të paktën 8 takime të Grupit Lokal të Veprimit brenda një periudhë 2-vjecare.
- Mbikëqyrë dhe monitorojë punën e grupit lokal të veprimit.
- Raporton mbi aktivitetet e grupit në nivel lokal dhe te partneri Kryesor.
- Merr pjesë në takimet e rrjetit transnacional dhe në aktivitetet e ngritjes së kapaciteteve, dhe
- Raporton te anëtarët e grupit lokal të veprimit për projektin.
- Së bashku me grupin lokal të veprimit dhe stafin e projektit harton planin lokal të veprimit duke përdorur metodologjinë e programit URBACT IV.
- Të ndajë informacion me ekipin e projektit, përfutuesit të projektit, donatorëve, etj .;
- Të bëjë përditësimin dhe raportimin e të gjitha informacioneve në lidhje me Projektin dhe të sigurojë që palët e interesuara të kenë qasje në të gjitha dokumentet publike të Projektit;
- Të jetë pjesë në çdo aktivitet që do të realizohet gjatë implementimit të projektit.
- Të përgatisë cdo dokument tjetër që i kërkohet nga punëdhënësi.
- Të përfaqësojë denjësisht vlerat dhe parimet sociale dhe humane.
- Të ruajë konfidencialitetin dhe etikën profesionale

b-Kualifikimet dhe aftësitë e kërkuara

- Të ketë mbaruar studimet Universitare
- Minimumi 3 vite eksperiencë të përgjithshme pune.
- Preferohet të ketë të paktën një eksperiencë pune në pozicione të ngjashme.
- Angazhimi i mëparshëm në projektet e Bashkimit Evropian do të ishte një vlerë e shtuar.
- Njohje të mirë të gjuhës angleze
- Aftësi shumë të mira komunikimi, organizimi, analitike dhe në programet kompjuterike (word, excel...)

d- Orari i punës

- 9 ditë në muaj (part-time, 40%)

f- Dokumentacioni

- Një letër interesi në gjuhën shqipe
- Një CV në gjuhën shqipe

Dokumentacioni do të dorëzohet personalisht nga kandidatët pranë Zyrës të Burimeve Njerëzore, Bashkia Përmet në dy kopje.

Vetëm personi i përzgjedhur do të dorëzojë gjithë dokumentacionin mbështetës për kriteret e kërkuara dhe të përmendur në CV.

g- Procedura e përzgjedhjes dhe shpalljet së kandidatit fitues

- Kandidatët të cilët kanë shprehur interes për këtë pozicion pune do të përzgjidhen nga Komisioni i Posaçëm i ngritur për këtë procedurë konkurrimi, sipas kriterëve të mëposhtme:

Kriteret	Pikët maksimale
Arsimimi	20
Eksperienca	30
Letra e motivimit	10

h- Afati i dorëzimit të dokumentacionit

- Afati për dorëzimin e dokumentacionit do të jetë deri në datën 18.09.2023, ora 15:00.